REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA RROGOZHINË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 5491 Prot.

Rrogozhinë, më 18.12.2025

**PROJEKT - VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS TË KËSHILLIT BASHKIAK RROGOZHINË PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 113 pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë "Qeverisja Vendore" e ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" e ndryshuar , në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 nënpika 1,1 gërma "b", të nenit 51 pika 3, të nenit 54 të ligjit Nr.139/2015, datë. 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore" dhe në zbatim të nenit 121 të Rregullores "Për organizmin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë" miratuar me VKB nr. 7, datë 27.01.2020. Pas konsultimit me Kryesinë e Këshillit, i propozojmë Këshillit Bashkiak ,

**T Ë  V E N D O S I :**

1. Miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2026 sipas lidhjes bashkëlidhur këtij projekt-vendimi, si dhe listës së shpenzimeve të Këshillit sipas tabelave dhe planit bashkëlidhur këtij projektvendimi, për vitin 2026 në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
2. Ky program pune përgjatë vitit 2026 në rast se gjykohet e arsyeshme nga Këshilli mund të pasurohet ose ndryshohet me Vendim Këshilli sipas rastit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi pas miratimit, Këshilli Bashkiak Rrogozhinë.
4. Ky projektvendim pas miratimit në Këshill hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar .

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**MUKADES GIXHARI**

**Adresa:** Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

**PROGRAMI I PUNËS I KËSHILLIT BASHKIAK RROGOZHINË PËR VITIN 2026**

**JANAR**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2026 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Miratimin e Planit të Barazisë Gjinore 2026-2028.
4. Diskutime nga komuniteti.
5. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
6. Mbledhja Plenare e Këshillit.

**SHKURT**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2026 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Raport mbi veprimtarinë e qendrës Kulturore Rrogozhinë, si dhe shqyrtim i Listës së aktiviteteve të planifikuara nga ky sektor në fushën e Kulturës dhe Turizmit për vitin 2026.
4. Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e Kullimit dhe Vaditjes si dhe gjëndjen e Rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.
5. Diskutime nga komuniteti.
6. Mbledhje komisionesh të Këshillit
7. Mbledhja Plenare e Këshillit.
8. Pjesëmarrje në takime dhe konferenca të ndryshme.

**MARS**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2026 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Shqyrtim dhe miratim i tavaneve përgatitore për secilin program buxhetor të Bashkisë Rrogozhinë.
4. Informim i Këshillit mbi "Parandalimin e dhunës me bazë gjinore".



CS CamScanner

5. Diskutime nga komuniteti.
6. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
7. Mbledhja Plenare e Këshillit.

**PRILL**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2026 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Raport nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe sektori i Shërbimeve Publike mbi masat e marra për përmisimin e shërbimeve ndaj qytetarit dhe përgatitjen e sezonit turistik.
4. Informacion mbi punën e bërë nga Policia Bashkiake dhe informacion nga Komisariati i Policisë Kavajë mbi rendin dhe sigurinë publike.
5. Konsultime për buxhetin dhe për tematika të tjera nëse lind nevoja.
6. Njohja e planit të masave për pyjet.
7. Diskutime nga komuniteti.
8. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
9. Mbledhja Plenare e Këshillit .

**MAJ**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2026 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Informacion nga sektori i Mbrojtjes ndaj Zjarrit (MZSH-së) mbi punën e bërë.
4. Miratim i projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm.
5. Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit për masat e marra për korrjen e të lashtave dhe masat e marra ndaj zjarrit.
6. Raportim nga administrata e bashkisë mbi ecurinë e iniciativës së Aleancës Gjinore të këshilltareve bashkiake.
7. Diskutime nga komuniteti.
8. Konsultime për buxhetin.
9. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
10. Mbledhja Plenare e Këshillit.



CamScanner

## QERSHOR

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2026 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Informacion mbi realizimin e treguesve ekonomikë të Njësisë së Ujësjellës - Kanalizime Rrogozhinë dhe masat e marra për furnizimin normal me ujë të banorëve të Bashkisë dhe të zonave turistike (plazhi i Spillesë dhe i Vilë Bashtovës).
4. Raport nga Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore mbi punën e bërë nga ky Sektor.
5. Raport nga Administratorët e Njësive Administrative Kryevidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj mbi mbarëvajtejen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Janar - Maj 2026.
6. Informacion nga Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse mbi evidentimin e problematikave në shkolla dhe marrja e masave për rregullimin e tyre.
7. Diskutime nga komuniteti.
8. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
9. Mbledhja Plenare e Këshillit.

## KORRIK

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2026 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Analizë nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social mbi realizimin e treguesve ekonomiko financiarë për 6 - mujorin e vitit 2026.
4. Analizë nga Drejtoria e të Ardhurave dhe e Zhvillimit Ekonomik mbi realizimin e të ardhurave për 6 - mujorin e parë të vitit 2026.
5. Informacion nga ZVA (Zyra Vendore Arsimore) Rrogozhinë mbi rezultatet e arritura nga përmbyllja e vitit shkollor 2025-2026.
6. Raport nga Drejtoritë përkatëse mbi zbatueshmërinë e Vendimeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar – Qershor 2026.
7. Diskutime nga komuniteti.
8. Mbledhje komisionesh të Këshillit
9. Mbledhja Plenare e Këshillit.

**Adresa:** Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

**GUSHT**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2026 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Informacion nga Drejtoria e Politikave Urbane dhe nga Sektori i Kadastrës dhe Pronave për punën e bërë në drejtim të aplikimeve të lejeve on - line, projekteve të reja, proçesin e legalizimit dhe evidentimin e problemeve të kadastrës dhe pronave.
4. Raport për gjëndjen ekonomiko-financiare të Bashkisë dhe Njësive Administrative nga Kryetari i Bashkisë, sipas gërmës "ç" të nenit 64 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.
5. Diskutime nga komuniteti.
6. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
7. Mbledhja Plenare e Këshillit.

**SHTATOR**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2026 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Shqyrtim i draftit të Projekt Buxhetit Afatmesëm (PBA) Rrogozhinë për vitin 2027-2029.
4. Informacion mbi punën e bërë nga Sektori i Pyjeve dhe përmisimin shërbimeve dhe veprimtarisë që ofron në këtë fushë.
5. Informacion mbi punën e bërë për përgatitjen e vitit të ri shkollor nga Drejtoria e Arsimit pranë Bashkisë.
6. Masat e marra nga Sektori i Bujqësisë dhe Kullimit për pastrimin e kanaleve të para të dyta e të treta dhe përgatitja e tyre për dimrin.
7. Diskutime nga komuniteti.
8. Mbledhje komisionesh të Këshillit
9. Mbledhja Plenare e Këshillit

**TETOR**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2026 nga fondi i pushtetit vendor.



CamScanner

3. Raport nga Kryetari i Bashkisë për zbatimin e Vendimeve të Këshillit për të cilat ai dhe ekzekutivi i Bashkisë dhe Institucionet / ndërmarrjet në varësi të Bashkisë janë përgjegjës për tremujorin e fundit ose sipas rastit e përmbledhur për peridhën Janar - Shtator 2026.
4. Analizë mbi realizimin e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve për 9-mujorin e vitit 2026.
5. Informacion nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe e Zhvillimit Ekonomik mbi punën e bërë dhe masat e marra për përgatitjen e dokumentit final të Paketës Fiskale dhe Buxhetit të vitit 2026.
6. Konsultime për buxhetin, paketën fiskale dhe për çështje të tjera.
7. Diskutime nga komuniteti.
8. Mbledhje komisionesh të Këshillit
9. Mbledhja Plenare e Këshillit

**NËNTOR**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2026 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-aktit për sistemin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2027.
4. Raport nga Auditi i Brendshëm mbi punën e bërë dhe problematikat e evidentuara nga ky Sektor në Administratën e Bashkisë Rrogozhinë, si dhe analizë mbi punën e bërë nga Administrata mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së në auditimin e fundit të realizuar dhe nxjerrjen e përgjegjësive në rastin e moszbatimit të këtyre rekomandimeve.
5. Raport nga Administratorët e Njësive Administrative Kryevidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj mbi mbarëvajtejen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Tetor 2026.
6. Vizitë shkëmbi eksperiencash në këshillat homolog.
7. Konsultime për buxhetin dhe për çështje të tjera.
8. Diskutime nga komuniteti.
9. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
10. Mbledhja Plenare e Këshillit.



CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

**DHJETOR**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2026 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Shqyrtim dhe miratim i Realizimit Faktik të Buxhetit 2026 të Bashkisë Rrogozhinë.
4. Shqyrtim dhe miratim i Projekt Buxhetit Afatmesëm Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2027- 2029.
5. Shqyrtim dhe miratim i Buxhetit të Bashkisë për vitin 2027.
6. Shqyrtim dhe miratim i Bursave të Shkollave të Mesme për Bashkisë Rrogozhinë.
7. Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2027-2029 dhe buxhetit vjetor.
8. Diskutime nga komuniteti.
9. Mbledhje komisionesh të Këshillit
10. Mbledhja Plenare e Këshillit.

**KRYETARE E KËSHILLIT**
**MUKADES GIXHARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA RROGOZHINË

**Adresa:** Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Keshilli Bashkiak Rrogozhine
BUXHETI VJETOR 2026

| Nr | Emertimi i shpenzimeve | Numri | Paga dhe sigurime mujore | Vlefta vjetore | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| 1 | Honorare per Keshillin (1/10 e pages se kryetarit) | 21 | Te merren nga financa | Shumezohet paga me numrin x 12 muaj | |
| 2 | Sekretari i Keshillit, page, sigurime shoqerore | 1 | Te merren nga financa | Shumezohet paga me numrin x 12 muaj | |
| | Honorare per kryetaret e fshatrave | 41 | Te merren nga financa | Shumezohet paga me numrin x 12 muaj | |
| 3 | Administratore te lagjeve - Qytet | 4 | Te merren nga financa | Shumezohet paga me numrin x 12 muaj | |
| 5 | Shpenzimet sipas Plani I punes I detajuar ne shpenzime ( detajuar ne sheet tjeter ) | | | 480,000 | Vlera vjen nga sheet Plani i punes detajuar i shpenzimeve |
| 6 | Shpenzime per konsultime (detajuar te plani vjetor i konsultimeve) | buxheti, paketa fiskale, shitja dhenje me qera e pronave, miratimi I komisioneve te keshillit, rregullores se keshillit, plani strategjik I zhvillimit te bashkise, | | 20,000 | Vlera vjen nga sheet "Plani i konsultimeve me shpenzime |
| Nr. | Investime | | | | |
| | TOTALI I SHPENZIMEVE | | | - | |

500,000

KRYETARE E KESHILLIT
MUKADES GIXHARI

CamScanner

mi i punes Keshilli Bashkiak Rrogozhine 2026

| Nr | Pershkrimi I aktivitetit | Periudha | | | | | | | | | | | | Numri | Shpenzime | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor | | Kancelari | Leter | Shtypshkrime | Karburant | Qera salle | Konsulence nga eksperte | Shpenzime per foni | Shpenzime media | Njoftime ne media | Dieta | Akomodim | Boje printer/foto kopje | Shpenzime pritje percjellje | Sherbime nga te trete per IT | Uje, Pije joalkolike | Totali I shpenzimeve |
| 1 | Mbledhje Keshilli -16 (12 cdo muaj plus 4 ne total te mbledhjeve jashte rradhe ose te jashtezakonshme nese do te lind nevoja) | 1 | 1 | 1 | 2 | 1 | 1 | 2 | 1 | 2 | 1 | 2 | 1 | 16 | | | | | | | | | | | | | | | 15000 | 15000 |
| 2 | Mbledhje Komisionit te Perhershem (mesatarisht 3-4 mbledhje komisionesh ne muaj) | 3 | 3 | 4 | 3 | 4 | 3 | 3 | 3 | 4 | 3 | 4 | 4 | 41 | | | | | | | | | | | | | | | 10000 | 10000 |
| 3 | Fond per aktivitet te Aleances se Grave Keshilltare Bashkiake | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 40000 |
| 4 | Vizite studimore / shkembim eksperiencash ne keshilla homologe brenda dhe jashte vendit ne rajon | | | | | | | | | | | | | | | | | 40000 | | | | | | 150000 | 195000 | | | | | 385000 |
| 5 | Mirembajtje pajisjesh te transmetimit live te mbledhjeve te keshillit bashkiak | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 30000 | | 30000 |
| TOTALI I SHPENZIMEVE | | | | | | | | | | | | | | | - | - | - | 40,000 | - | - | - | - | - | 150,000 | 195,000 | - | - | 30,000 | 25,000 | 480,000 |

**Plani vjetor i konsultimeve Keshilli Bashkiak**

**Rrogozhine 2026**

| | Tema | Lloji i konsultimit | Numri I konsultimeve | Shpenzimet | | | | | | | | | | | | | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kancelari | Leter | Shtypshkrime | Karburant | Qera salle | Shpenzime per foni | Shpenzime media | Njoftime ne media | Dieta | Akomodim | Boje printer/ fotokopje | Sherbime nga te trete per IT | Totali i shpenzimeve | |
| 1 | Buxheti vjetor dhe PBA | Flete palosje | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | Degjese publike Bashkia qender | 1 | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Degjese publike NjA | 1 | | | | 5,000 | | | | | | | | | 5,000 | |
| | | Degjese publike me OJF/etj | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Emision televiziv | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | etj | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| 2 | Paketa fiskale | Flete palosje | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Degjese publike Bashkia qender | 1 | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Degjese publike NjA | | | | | 5,000 | | | | | | | | | 5,000 | |
| | | Degjese publike me OJF/etj | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Emision televiziv | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | etj | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| 6 | Konsultim per blerje/ qera/ tjetersim prone (shpronesim) | Flete palosje | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Degjese publike Bashkia qender | 1 | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Degjese publike NjA | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Emision televiziv | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | etj | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| 8 | Miratimi i planit te sherbimit publik per secilin prej sherbimeve publike bashkiake | Flete palosje | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Degjese publike Bashkia qender | 1 | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Degjese publike NjA | 1 | | | | 5,000 | | | | | | | | | 5,000 | |
| | | Degjese publike me OJF/etj | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Emision televiziv | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | etj | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| 9 | Konsultim per planin strategjik te bashkise (miratim apo rishikim) | Degjese publike Bashkia qender | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Degjese publike NjA | | | | | 5,000 | | | | | | | | | 5,000 | |
| | | Degjese publike me OJF/etj | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| 10 | Konsultim per planin e pergjithshem vendor apo ndryshimet e tij (ligji nr. 107/2014) | Degjese publike Bashkia qender | 1 | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Degjese publike NjA | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | | Degjese publike me OJF/ndertues etj | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | | | **0** | **0** | **0** | **20,000** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **20,000** | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA RROGOZHINË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 5491/1 Prot. Rrogozhinë, më 18.12.2025

**RELACION**

**PËR PROGRAMIN E PUNËS TË KËSHILLIT BASHKIAK RROGOZHINË PËR VITIN 2026**

Të nderuar këshilltarë,

Të nderuar Kryetare/ë të Komisioneve të Përhershme të Këshillit

Programi i Punës së Këshillit për vitin 2026, shoqëruar me planin e detajuar të konsultimeve dhe buxhetin e nevojshëm, është hartuar në mbështetje të nenit 54 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore ", Ligji nr. 68, datë 27.04. 2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligje të tjera relevante me ndikim në funksionimin e qeverisjes vendore në përgjithësi dhe Këshillin Bashkiak në veçanti dhe rregulloreve specifike të miratuara në Këshillin Bashkiak Rrogozhinë.
Në mbështetje të nenit 51/3 , nenit 54 të ligjit 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe në zbatim të Rregullores së Funksionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, Neni 119 "Programi i Punës së Këshillit Bashkiak", Ju propozojmë *"Programin e Punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2026"*.
Ky program pune ka për qëllim të përcaktoj aktivitete mujore që duhet të ndiqen nga Këshilli Bashkiak për organizimin e tij në një mënyrë sa më të plotë dhe efiçente. Gjithashtu trajton në mënyrë të detajuar të gjitha pikat e rendit të ditës mujore, (por gjithmonë duke patur parasysh dokumentacionin që do të hartojë dhe do të paraqesë administrata e bashkisë Rrogozhinë), sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Plani bashkëlidhur.

Sipas këtij relacioni, do të mbështeten dhe aktivitetet që Këshilli ka, në përputhje me funksionet e veta dhe në shërbim të interesit të komunitetit siç janë dhe seancat këshillimore për të gjitha rastet, që parashikon ligji. Shpenzimet e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për aktivitetet e vitit 2026 do të jenë 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

**Adresa:** Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Këto fonde kërkohet të shqyrtohen dhe detajohen në mbledhjen e Kryesisë të thirrur për këtë qëllim dhe në mbledhjen e radhës së Këshillit ku do të shqyrtohet ky projektvendim. Fondet do të miratohen nga Këshilli në Buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026 i cili do të sillet në Këshill për miratim në muajin Dhjetor 2025.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**KRYETARE E KËSHILLIT**
**MUKADES GIXHARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA RROGOZHINË

**Adresa:** Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner